

## Udhëzime rreth hyrjes dhe kthimit në Schleswig-Holstein

### Çka duhet të kenë parasysh udhëtarët ?

Në përgjithësi rekomandohet, që për shkak të Corona-Pandemisë të gjithë udhëtarët që vijnë nga vendet e huaja, pamarrë parasysh nga cili vend, duhet të kontaktojnë me Entin Shëndetësor lokal, për tu sqaruar nese kërkohen masa të mëtejshme.

E rëndësishme është, që ju para se të ktheheni të verifikohet nese ju ktheheni nga një zonë e rrezikut. Për zonat e rrezikut të brendshëm si dhe për përjashtimet, mund ti gjeni te faqja e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë ([www.schleswig-holstein.de/msgjfs](http://www.schleswig-holstein.de/msgjfs)), ndërsa për zonat e rrezikut jashtë vendit, mund ti gjeni në faqet e internetit të Robert Koch-Instituts ([www.rki.de](http://www.rki.de)).

Për te gjithë ata udhëtar që kthehen nga zonat e rrezikut në Schleswig-Holstein **duhet të zbatohen rregullat në vijim:**

➔ Drejtperdrejtë në shtëpi ose në ndonjë akomodim tjetër të pershtatshem.

➔ Kontaktoni Entin Shëndetësor lokal për tu informuar mbi udhëtimin.

➔ Për simptomat që tregojnë një infeksion me Koronavirus, menjehere të informohet Enti Shëndetësor lokal.

➔ Në shtëpi, ose në ndonjë akomodim tjetër, 14 ditë të qëndroni në Karantinë. Në këtë kohë nuk lejohen vizitat nga persona të tjerë, përpos familjarëve.

...ose...

➔ Alternativ tjetër për karantinë, mund të bëhet testi i Koronës, me një rezultat negativ të provës (që nuk duhet të jetë më i vjetër se 48 orë) mund të dilni nga karantina (vetizolimi). Për ata që sjellin këto teste negative nga vendet e jashtme nuk vlejnë këto kërkesa. Rezultatet e provës duhet të ruhen 14 ditë, nëse kerkohet duhet të paraqiten. Derisa në marrjen e rezultatit të testit negativ vlen karantina (vetizolimi).

Për informacionet dhe për të dhënat e kontaktit per Entet Shëndetësore lokale, mund ti gjeni ketu: [www.schleswig-holstein.de/coronavirus-einreise](http://www.schleswig-holstein.de/coronavirus-einreise)



#### Në rast të shkeljeve të masave mbrojtëse në përputhje me paragrafin 3 të rregullave shtetërore mbi masat per karantinë (vetizolimi) mund të shqiptohen gjokat:

Shkelje	Gjokë
Nëse jeni kthyer nga udhëtimi nga zonat e rrezikut dhe nëse i shkelni rregullat e karantinimit per 14 ditë si në shtëpinë tuaj ose në ndonjë strehim tjetër të pershtatshem...	500 € - 10.000 €
Nëse jeni kthyer nga udhëtimi prej zonave të rrezikut dhe nuk shkoni direkt në shtëpinë tuaj ose në ndonjë strehim tjetër të pershtatshem...	150 € - 3.000 €
Nëse ju përkunder sigurimit të karantines (vetizolimit) pas kthimit nga udhëtimi prej zonave të rrezikut, pranoni vizitor...	300 € - 5.000 €
Nëse ju nuk lajmëroheni menjehere në Entin Shëndetësor përkatës pas kthimit nga zonat e rrezikut...	150 € - 2.000 €
Nëse ju udhëtoni për në Schleswig-Holstein dhe rruga e juaj tranzitore ka qenë nëper një zonë rrezikur dhe nuk jeni larguar direkt...	150 € - 3.000 €
Nëse ju pas kthimit nga udhëtimi keni simptoma të koronës dhe nuk lajmëroheni menjehere në Entin Shëndetësor, gjithashtu edhe nëse simptomat shfaqen më pas...	300 € - 3.000 €